



KOMUNA E SHITES
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Nr. 09/41

Datë: 22. 3. 2023

THIRRJE PUBLIKE PËR OFRIMIN E MBËSHETJES FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTET E OJQ-ve PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE NË KOMUNËN E SHITES.

Në bazë të nenit 12 të Rregullores MF Nr.04.2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Shtimes shpall thirrje për të gjitha organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Sportit, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masovizimin e Sportit.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:
2.1. Të gjitha OJQ-të-Klubet Sportive, në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e sportit.
3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e Sportit.
4. Vlera totale e planifikuar, e thirrjes është: **44,000.00 euro**
5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, nga data **22. 3. 2023** deri më datë **11. 4. 2023, në ora 16:00.**
6. OJQ-të mund të aplikojnë me projekte në kuadër të kësaj thirrjeje, por vetëm me një projekt për fushën sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të thirrjes është deri në **dhjetor të vitit 2023.**
7. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Shtimes, së paku tre muaj para datës së publikimit të thirrjes publike.
8. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat e lartëpërmendura.
9. OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
10. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqes prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.
11. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët së bashku me udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në uebfaqën e internetit të Komunes së Shtimes. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën: Rruga "Tahir Sinani" Nr. 50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës / Komuna Shtime / Zyra e Sportelit.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlersimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

15. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS.

Drejtoresha, Albana Fazliu

